



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 94-të të mbajtur më 13.10.2023, ka miratuar sa vijon.

### Vendim

Denoncimi me numër 12-182/1 të datës 11.01.2023, me pretendime për pakënaqësi nga veprime në procedurën administrative lidhur me kërkesën për ndihmë sociale, HIDHET POSHT

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për faktin se pretendimet në denoncimin e lëndës i referohen çështjeve që nuk janë objekt veprimi të tij kompetent dhe për të cilin është kompetent të veprojë një autoritet tjetër.

Lënda me numër 12-182/1 nga 11.01.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

### Arsyetim

Një parashtrues i njohur, më datë 11.01.2023, ka dorëzuar denoncim në adresën elektronike të KSHPK-së, sipas së cilës është konstatuar lënda nr. 12-182/1 nga 11.01.2023 me pretendime për pakënaqësi me veprimet e institucioneve në procedurë administrative dhe kërkesë drejtuar Qeverisë së RMV-së dhe Komisionit Vendimmarrës, me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të rastit të formuar pas kërkesës për dhënien e ndihmës sociale më datë 30.08.2022 nga personi ----- nënë e vetme dhe viktimë e dhunës në familje.

Në denoncim thuhet se në vitin 2019, personit të përmendur i është kompensuar ndihma sociale për fëmijë dhe shtesa arsimore, dhe më datën 30.08.2022 ka paraqitur kërkesë të re për ndihmë sociale të cilës nuk i është përgjigjur, si dhe i është dorëzuar kërkesë edhe në adresën elektronike të Komisionit për vendimmarrje. Për rastin është njoftuar Avokati i Popullit.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se në rastin konkret bëhet fjalë për pretendime për çështje që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent dhe për të cilat është kompetent për të vepruar një autoritet tjetër. Nga aty KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në këtë rast dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHETËTOR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
**Kryetar,**  
**Biljana Ivanovska**

Dorëzuar: parashtruesi i denoncimit  
Përgatiti: J.C.  
Miratoi: G.T., Anëtar i KSHPK-së

